

Z. Luan Kuka ka kryer studimet e larta në periudhën 1884-1990, në Universitetin e Tiranë Fakulteti i Gjeologji Miniera, Diplomuar Inxhinier shpim nafte. Ka kryer studimet pasuniversitare Tetor 2015-Shkurt 2016, pranë Fakulteti Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik Tiranës, Certifikuar “Ekspert për Vlerësimin e pasurive te paluajtshme”. Ne vitin 2017 ka ndjekur kursin për vlerësimin mjedisor, certifikuar “Ekspert për vlerësimin e ndikimit ne mjedis”.

Prej vitit 2013, ai ka ushtruar pozicionin e Audituesit të Parë, Audituesit të Lartë e më pas Kryeaudituesit në departamente auditimi.

Aktualisht është Kryeauditues në Departamentin e Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit prej datës 16.12.2022.

Ka filluar të punojë pranë këtij institucioni në Shtator te vitit 2013 si “Auditues i Jashtëm”.

Në periudhën 2006-2013 ai ka punuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë në pozicione të ndryshme, si specialist, inspektor, Drejtor Drejtorie, në Drejtorinë e Inspektimit pranë këtij institucioni. Në këtë institucion ai ka ndjekur probleme të ndryshme lidhur me survejimin e tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit. Në periudhën 1996 – 2005 është marrë me aktivitet privat në fushën e biznesit. Në periudhën 1990 – 1995 ka punuar në Ndërmarrjen Gjeologjike Burrel, ku ka ndjekur zbatimin e proceseve teknike në fushën e kërkim-zbulimit të mineraleve, duke kontribuar në hartimin e preventivave dhe përcaktimin e kostove paraprake të puseve të shpim kërkimit në Ndërmarrjen Gjeologjike Burrel.

Ai gjatë karrierës së tij profesionale, para dhe gjatë punës në KLSH, ka marrë pjesë në disa konferenca, seminare dhe workshope të organizuara nga organizma dhe projekte ndërkombëtare, që lidhen me implementimin e direktivave të BE-së në fushën e Metrologjisë, fushën e survejimit të tregut dhe performancën e trupës inspektuese, të organizuara nga PTB(Instituti Gjerman i metrologjisë), UMNZ-Prage dhe BEV-Vienë.

Gjatë punës në KLSH, ka marrë pjesë në disa konferenca, seminare dhe workshope të organizuara nga organizma dhe projekte ndërkombëtare, me temë “Mbi luftën kundër korrupsionit” organizuar nga NIKU Polak, me temë “Mbi auditimin e sistemit të IT”, organizuar nga Gjykata e Llogarive të Turqisë, “Mbi prokurimet publike”, zhvilluar ne Portorozo, Slloveni.